



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 1298/prot.
2

Pogradec, më 21.03 2024

VENDIM

Nr. 28, DATË 21/03/2024

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 10,4682 HA, E NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE PROPTISHT, TREBINJE, BUÇIMAS QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e sipërfaqes së tokës bujqësore prej **10.4682** Ha (Dhjetë hektar dhe katërmije e gjashtëqind e tetdhjetë e dy metra), të ndodhur në Njësitë Administrative Proptisht, Trebinjë, Buçimas që mund të jepen me qira sipas listës.

Nr	Pronësia	Zona Kadastrale	Numëri Pasurisë	Vëndodhja Fshati	Lloji Pasurisë	Sipërfaqja në m ²
1	Shtet	3280	35/1	Selcë e Poshtëme Proptisht	PF	40000
2	Shtet	3745	608/1	Vërdovë Buçimas	Arë	12700
3	Shtet	3036	160/1	Potkozhan Trebinjë	Pemtore	13000
4	Shtet	3036	530/1	Potkozhan Trebinjë	Arë	7900
6	Shtet	2928	30	Peshkëpi Buçimas	Arë	3375
7	Shtet	2928	31	Peshkëpi Bucimas	Are	15525
8	Shtet	2928	84/23	Peshkepi Buçimas	Are	3770
9	Shtet	2928	127	Peshkepi Bucimas	Are	8412
				Totali		104682

2. Toka Bujqësore që do të jepet me qira do të shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe 3. te tjera veprimtari ne funksion te saj.

4. Afati i dhënies me qira do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë: 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara".

5. Çmimi dysheme i vlerës së qerasë nuk do të jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në

vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".

6.Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Njësitë Administrative Proptisht, Trebinjë, Buçimas .

7.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

NËN/KRYETARE E KËSHILLIT

Albana PRIFTI



1.Miratuar me 19 vota

2.Vota Pro 19

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 4

5.Zbardhur më date 19.03.2024